

Migrantët pa dokumente

kan të drejtë për të

marrë kujdes shëndetësor

Që nga viti 2013, kan migrantët pa dokumenta të drejtën ligjore të përdorin disa shërbime shëndetësore të subvencionuara si pas ligjit 2013:407.

E drejta për të marrë kujdes

shëndetësor

Të rriturit

Ju keni të drejtën që të merrni të njëjtën kujdes shëndetësor si një azil kërkues i rritur. Kjo do të thotë kujdes shëndetësor që nuk mund të shtyhet, përfshi problemet dentare, kujdesin për shtatzëninë (kontrollat e shtatzënisë), këshillat për kontraktivë kujdesin shëndetësor të lidhur me aborte dhe një kontroll mjekësor. Përveç këtyre rrethit i është dhënë mundësia që të ofrojë kujdes shëndetësor deri në të njëjtën nivel sikurse për banorët e tjerë. Personeli i kujdesit shëndetësor vlerëson nëse ju nevojitet kujdes që nuk mund të shtyhet.

Fëmijët

Të gjithë fëmijëve që jetojnë në Suedi do t'u ofrohet i njëjti kujdes shëndetësor sikurse banorëve dhe fëmijëve që kërkojnë azil, d.m.th., kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës i subvencionuar përfshi kujdesin e rregullt dentar.

Pagesat

Shumica e kostos për kujdesin shëndetësor paguhet nga shteti. Pjesa që duhet të paguani vetë quhet pagesa e pacientit:

- Pagesa e pacientit mund të ndryshojë nga rrethi në rreth.
- Vizitat e doktorit në qendrën e kujdesit shëndetësor ose në pavionin e urgjencave: 50 kr
- Tërheqjet farmaceutike: 50 kr
- Kontrollat dhe kujdesi shëndetësor që kryhet sipas ligjit për Sëmundjet Infektive do të jenë falas.

Gjërat që duhen patur parasysh

Numri i rezervuar: Kur të keni kontakt me kujdesin shëndetësor do të merrni një numër të rezervuar, e ky numër do të funksionojë vetëm si identifikim brenda kujdesit shëndetësor. Lutemi silleni gjithnjë me vete numrin tuaj të rezervuar kur vizitoni kujdesin shëndetësor. Përpiquni të përdorni të njëjtin numër të rezervuar në secilën vizitë. Nëse nuk e dini numrin e rezervuar lutemi kontrolloni që/nëse keni tashmë një numër përpara se të krijoni një numër të ri.

Identifikimi: Është mirë që të sillni me vete një dokument identifikues me vete kur të kontaktoni me shërbimet e kujdesit shëndetësor (kartë identiteti ose kartë LMA, pasaportë ose kopje të dokumentit të identifikimit). Nëse nuk keni një dokument identifikimi, ju gjithësesi keni të drejtën të përdorni kujdesin shëndetësor.

Informacioni i kontaktit: Kujdesi shëndetësor në disa raste duhet t'ju kontaktojë dhe për këtë arsye ne ju kërkojmë një adresë ose numër telefoni. Nëse keni një adresë të dikujt tjetër, është e rëndësishme që ju të jepni emrin e personit që është vendosur në derë. Nëse nuk keni një adresë, mund të lini thjesht një numër telefoni. Nëse nuk mund të flisni suedisht, është mirë që të jepni numrin e telefonit të një personi që flet Suedisht.

Fshehtësia: I gjithë personeli i kujdesit shëndetësor janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë profesionale dhe ata nuk kanë të drejtë të kontaktojnë autoritetet publike si për shembull Shërbimi i Imigracionit dhe policia.

Farmacia: Recetat elektronike duhen marrë në një farmaci të caktuar. Recetat elektronike normalisht kërkojnë që ju të identifikoheni. Prandaj, preferohet një recetë në letër.

**Në rast të një sëmundjeje akute:
shkoni në pavijonin më të afërt të
urgjencës!**

Numra të rëndësishëm telefoni:

Ambulanca:

112

Këshilla mjekësore:

1177

Këshilla mjekësore në somalisht:

0771 – 11 77 91

Këshilla mjekësore në arabisht:

0771 – 11 77 90

Nëse keni pyetje ose doni të mësoni më shumë,
kontaktoni Agjencinë e Shëndetit të Kryqit të Kuq në:

Stokholm

Telefoni: 020-21 10 00

e hënë – e enjte 9:30 deri 11:30

E-maili: papperslos@redcross.se

